



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2021

VENDIM
Nr. 214, datë 26.05.2021

PËR
MIRATIMIN E FORMËS STANDARDE TË AKTEVE TË VLERËSIMIT TË
NDIHMËSMAGJISTRATIT NË GJYKATËN E LARTË

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenin 147, pika 1, shkronja “a” të Kushtetutës, nenet 2, 70, pika 3, 74-78, 84-95, 97 dhe 171 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.193, datë 12.05.2021 “Për miratimin e “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë” dhe nr.194, datë 12.05.2021 “Për miratimin e “Rregullat e vlerësimit të gjyqtarëve të komanduar në Gjykatën e Lartë”, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale,

V E N D O S I :

1. Miratimin e formës standarde të akteve të vlerësimit të ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë, sipas Lidhjes 1, 2 dhe 3 pjesë e përbërëse e këtij vendimi.
2. Format standarde të akteve të vlerësimit hartohen në format shkresor dhe/ose elektronik, të cilët kanë vlerë të njëjtë.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR